



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 445, datë 29.6.2022

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E TRI OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, dhe të pikës 4, të nenit 5, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Katarit për Zhvillim, për financimin e rikonstruksionit të dy shkollave dhe një kopshti në Bashkinë Tiranë, miratuar me vendimin nr.774, datë 30.9.2020, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 303 102 373.21 (treqind e tre milionë e njëqind e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre pikë njëzet e një) lekë pa TVSH, nga Bashkia Tiranë, për mbulimin e kostove shtesë, në zbatim të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Katarit për Zhvillim, për financimin e rikonstruksionit të dy shkollave dhe një kopshti në Bashkinë Tiranë, për objektet arsimore:

- i. Shkolla 9-vjeçare "Lasgush Poradeci";
- ii. Shkolla e mesme e bashkuar "16 Shtatori";
- iii. Çerdhe/kopsht nr.42.

2. Efekti financiar të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 3719/3  
DATE 30. 6. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I  
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E  
REFORMAVE  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
BASHKISË TIRANË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaçi', written over the printed name.